

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7186  
E premte, 17 maj 2024  
Çmimi 0.50

### Blinkeni u thotë ukrainasve se ndihma ushtarake "është rrugës"

FACE 2



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



## PËRPLASJE NË MES TË QEVERISË DHE PRESIDENCËS PËR LETRËN DËRGUAR NË KIE PA KONSULTIM ME PRESIDENTEN OSMANI

FACE 4-5



Ministria për Punë të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka bërë me dije se në kuadër të procesit të anëtarësimit në Këshillin e Evropës, të mërkurën i ka dërguar një letër presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Ajo ka

thënë se letra përmban zotimin që Qeveria e Kosovës do të përgatisë një draft për krijimin e një mekanizmi për vetëmenaxhim, koordinim dhe bashkëpunim të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Gërvalla ka shtuar se presin nga Këshilli i Evropës ta

përbushë pjesën e vet të detyrimit dhe ta ftojë Kosovën për t'u bashkuar pa vonesë Këshillit të Evropës. Por nga Presidencia kanë reaguar duke theksuar se për letrën dërguar në KIE nuk janë konsultuar dhe marrë vesh me presidenten Osmani

### AKTUALE



**BIDENI DHE TRUMPI PAJTOHEN PËR DY DEBATE ZGJEDHORE** F. 2

**FICOS I KTHEHET VETËDIJA, POR MBETET NË "GJENDJE TË RËNDË"** F. 5

**AKTAKUZË NDAJ DY SERBËVE PËR KRIME LUFTE NDAJ SHOIPTARËVE** F. 5

### EKONOMI



**BE-JA: KOSOVA DHE SERBIA, PA GATISHMËRI PËR KOMPROMIS RRETH PËRDORIMIT TË DINARIT** F. 8

**MINISTRI MURATI MERR PJESË NË SEANCËN PLENARE TË BORDIT TË GOVERNATORËVE TË BERZH-IT** F. 8

### SPORT



**DELEGACIONI I DINAMO ZAGREBIT SOT VJEN NË KOSOVË** F. 10

**KUVENDI MIRATON DISA MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE, EDHE ATË USHTARAKE ME TURQINË** F. 3



**"SECILI DUHET TA BËJË PJESËN E VET TË PUNËS", MESAZHI NGA SAMITI I LIDERËVE RAJONALË DHE TË BE-SË** F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Mapedoni  
Xingyitë - Tetovë  
Gurke-Perleja  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 302 / +389 44 487 070 / +389 44 487 753  
Fax: +389 44 487 200  
Më: +389 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-kc.com](http://www.princesha-kc.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYRKOL - BUNJAKOL - CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
028 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP BILA  
BEJA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)39 246 301 Fax: +381 (0)39 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni dhe Trumpi pajtohen për dy debate zgjedhore

**WASHINGTON, 16 MAJ** - Presidenti amerikan Joe Biden dhe ish-presidenti Donald Trump janë pajtuar të mërkurën për të mbajtur dy debate zgjedhore në qershor dhe në shtator.

I pari do të mbahet më 27 qershor në televizionin CNN, i dyti më 10 shtator në transmetuesin ABC.

Marrëveshja e shpejtë mes tyre vjen pasi Bideni, demokrat, njoftoi se nuk do të marrë pjesë në debate zgjedhore që sponsorizohen nga komisioni jopartiak, i cili ka më shumë se tri dekada që i organizon ato.

Fushata e Bidenit propozoi që debatet mes tij dhe kandidatit të supozuar republikan të organizohen drejtpërdrejt nga mediet dhe që debati i parë të mbahet në fund të qershorit, kurse i dyti në shtator.

Trumpi shkroi në rrjetin e vet

social, "Truth Social", se është i "gatshëm dhe dakord për debat" me Bidenin në kohët e propozuara.

Disa orë më vonë Bideni tha se e ka pranuar ftesën e CNN-it për një debat më 27 qershor, duke shtuar: "Urdhëro, Donald! Siç thatë: kudo, në çfarëdo kohe, në çfarëdo vendi".

Trumpi tha për "Fox News Digital" se e ka pranuar ftesën: "Do të jem aty".

Por, palet duket se kanë mospajtime të mëdha rreth çështjeve kyçe për mënyrën e organizimit të debateve, përfshirë rreth pajtimit për moderatorët dhe rregullat.

Çështje të tilla e kishin nxitur krijimin e komisionit për debatet presidenciale më 1987.

Fushata e Bidenit kishte propozuar përfshirjen e kandidatëve të palës së tretë, siç



është Robert F. Kennedy Jr., nga debatet. Sipas rregullave të komisionit të debateve, Kenney apo kandidatët e tjerë të palës së tretë mund të kualifikohen nëse sigurojnë qasje të mjaftueshme në fletëvotime për t'i fituar 270 vota elektorale

dhe nëse marrin 15 për qind apo më shumë në sondazhe kombëtare.

CNN tha se debati do të mbahet në Atlanta dhe se "nuk do të ketë audiencë". Transmetuesi amerikan tha se Kennedy apo ndonjë kandidat tjetër mund të

marrë pjesë nëse i plotëson kërkesat e ngjashme me ato të komisionit.

Trumpi kishte shprehur dëshirën për debat me audiencë të madhe.

Bideni dhe Trumpi kanë shkëmbyer komente në rrjetet sociale në lidhje me debatin e fundit mes vete para zgjedhjeve presidenciale më 2020, secili duke pretenduar fitoren.

"Donald Trumpi i humbi dy debate kundër meje më 2020. Prej atëherë ai nuk është shfaqur për debat", tha Bideni në një postim në rrjetin social "X". "Tani ai po sillet sikur dëshiron përsëri debat. Epo, më bëj të lumtur, mik".

Trumpi, në anën tjetër, tha se Bideni është "debatuesi më i dobët me të cilin jam përballur ndonjëherë. Ai nuk mund t'i lidhë dy fjalë bashkë".

## Tirana i kërkon sqarim ambasadorit serb rreth deklaratës së Vulinit për Ramën

**TRIANË, 16 MAJ** - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë ka thirrur në bisedë ambasadorin serb në Tiranë, Slobodan Vukçević, dhe i ka kërkuar sqarime për një deklaratë të bërë nga zëvendëskryeminstri Aleksandar Vulin në lidhje me një takim që ka zhvilluar kryeministri shqiptar Edi Rama në Greqi.

Numri dy i qeverisë serbe reagoi pas takimit që kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, zhvilloi me emigrantët shqiptarë në Athinë më 12 maj.

Vulin tha se "Shqipëria e Madhe" mund të ndalet vetëm nga serbët dhe "Bota Serbe", por edhe ju grekë të dashur, ju lutem mendojini këtë".

Ministria e Jashtme e Shqipërisë e cilësoi deklaratën e Vulinit si "provokuese, në kundërshtim me frymën e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe nuk i



shërben paqes dhe stabilitet në vendet e Ballkanit".

Kjo ministri tha se Shqipëria është faktor i rëndësishëm që punon dhe kontribuon për paqen dhe sigurinë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, dhe kjo është "në thelb të bashkëpunimit edhe me Serbinë".

Ministria për Evropën

dhe Punët e Jashtme pret reflektim të menjëhershëm, në mënyrë që deklarata të tilla të mëdhme, të përsëritura, të mos ndikojnë në marrëdhëniet tona, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt fqinjësisë së mirë dhe integritit evropian", u tha në reagim.

Mediet serbe raportuan më 13

maj se zëvendëskryeministri serb Aleksandar Vulin ka kërkuar aleancë me Greqinë, për të ndalur, atë që e ka quajtur "Shqipëri të Madhe".

"Herën tjetër që Qeveria e Greqisë të mendojë për njohjen e së ashtuquajturës Kosovë, le të kujtojë se si duket prita e Edi Ramës në mes të Athinës. Atë që Rama nuk mundi ta përjetonte në Tiranë, e përjetoi në Athinë. Njohja e së ashtuquajturës Kosovë nga autoritetet greke dhe pranimi i Prishtinës në Këshillin e Evropës do të ishte një kontribut i pamatshëm i Qeverisë së Greqisë dhe Dora Bakoyannis në krijimin e 'Shqipërisë së Madhe'. Shqipëria mund të ndalet vetëm nga serbët dhe 'Bota Serbe', por edhe nga ju grekë të dashur, grekë tanë. Ju lutem mendoni për këtë", citohet të ketë thënë Vulini.

Për një kohë të gjatë Vulini

proklamon idenë e "Botës Serbe", apo projektin për bashkimin e serbëve kudo që ata janë. Një projekt i tillë është parë si kërcënim për rajonin.

Kjo nuk është hera e parë që deklarata e Vulinit shtynjë Shqipërimë të kërkojë sqarime nga ambasadorët serbë në Tiranë. Para katër vjetësh Tirana kërkoi sqarime nga ambasadori serb për shkak të një qëndrimi të Vulinit, që atëbotë ishte ministër i Mbrojtjes. Në atë kohë Vulini kishte reaguuar lidhur me një deklaratë të Ramës se porti i Durrësit do të jetë de facto port i Kosovës. Kjo deklaratë ishte bërë gjatë një konference të përbashkët mes Ramës dhe homologut të Kosovës në atë kohë, Avduallah Hoti. "Duke deklaruar se Porti i Durrësit do të jetë i Kosovës, Durrësit do të jetë i Kosovës, Durrësit do të jetë i Kosovës" dhe "Shqipërisë së Madhe", kishte deklaruar Vulini.

## Ficos i kthehet vetëdija, por mbetet në "gjendje të rëndë"

**BRATISLAVË, 16 MAJ** - Kryeministri të Sllovakisë, Robert Fico, i cili u plagos rëndë në nëntë atentat - i është rikthyer vetëdija pasi iu nënshtrua një operacioni disaorësh, njoftuan mediet vendore të enjten. Ndërkohë, ndaj një të dyshuari është ngritur aktakuzë për tentim-vrasje.

Zyrtarët e spitalit në qytetin qendror të Sllovakisë, Banska Bistrica, thanë se lideri populist, 59 vjeç, iu nënshtrua

një operacioni pesorësh, i cili u krye nga dy epike mjekësh mbremjen e 15 majit. Fico luftoi për jetën si pasojë e plagëve të rënda nga të shtënata. "Gjatë natës, mjekët ia dolën ta stabilizojnë gjendjen e pacientit", tha zëvendëskryeministri Robert Kalinak për gazetaret që ishin mbledhur pranë spitalit ku po mjekohet Fico.

"Fatkeqësisht, gjendja e tij është ende serioze, sepse plagët janë të komplikuar",

tha Kalinak, i cili është edhe ministër i Mbrojtjes dhe aleat i ngushtë i Ficos në partinë e tij Smer. Sipas tij, sulmuesi ishte i "motivuar politikisht".

Mediet lokale raportuan të enjten se i dyshuarit për atentatin ndaj Ficos, i cili u arrestua në vendin e ngjarjes pak çaste pasi shtiu me armë zjarri, akuzohet për tentim-vrasje.

Emri i të dyshuarit nuk është bërë me dije, por mediet raportojnë se ai është një



burrë 71-vjeçar. Presidentja sllovaqe Zuzana Caputova bëri thirrje të enjten

që të ndalet "urrejtja e dhunshme" që e ka kapluar Sllovakinë.

## “Secili duhet ta bëjë pjesën e vet të punës”, mesazhi nga samiti i liderëve rajonalë dhe të BE-së

**PRISHTINË, 16 MAJ** - Plani i Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor paraqet një sinjal të qartë të përkushtimit të Bashkimit Evropian (BE) për transformimin ekonomik dhe demokratik të këtyre vendeve, tha kryeministri i Malit të Zi, Miloško Spajiq, në samitin e liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të BE-së që po mbahet në Kotor.

Këshilli i BE-së miratoi një plan prej 6 miliardë eurosh për t'i mbështetur vendet e Ballkanit Perëndimor me qëllim të përshtetimit të reformave dhe rritjes ekonomike, nga të cilat dy miliardë euro janë grante dhe katër miliardë euro kredi dhe t'i japë BE-ja.

Në samitin e organizuar nga Spajiq, përveç liderëve të rajonit, marrin pjesë edhe komisionari evropian për fqinjësi dhe zgjerim, Oliver Varhelji dhe ndihmëssekretari i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien.

Në këtë samit Kosovë përfaqësohet nga kryeministri Albin Kurti.

Samiti po organizohet me

sloganin “Një rajon, vizion i përbashkët”.

O'Brien tha se prioriteti i Planit të Rritjes ekonomike për Ballkanin Perëndimor është krijimi i një tregu të vetëm të qarkullimit të parastë, zvogëlimi i kostove, lehtësimi i lëvizjes së tregut dhe krijimi i më shumë vendeve të punës: “Mesazhet e Planit janë që për çdo pjesëmarrës, mesazhi është i qartë: bëje punën tënde dhe mos kërkë nga dikush tjetër të bëjë diçka më parë për ta bërë tënden”.

Varhelji tha se Plani i Rritjes nuk është më një draft, por një udhërrëfyes i cili është i dobishëm për rajonin përpara se të anëtarësohet në BE: “Për shkak të Planit të Rritjes dhe intensitetit të ndihmës nga plani ekonomik dhe investues, agenda e reformave dhe ndihmës financiare shtesë deri në vitin 2027, Ballkani do të jetë gati, ose mund të jetë gati, ose mund të bëhet gati për t'u anëtarësuar në BE”.

Kryetarja e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Borjana Krišto, tha se vendi ra dakord për 110 reforma nga 113 që ishin propozuar fillimisht nga BE-ja. “Rruga evropiane është synimi



kryesor i politikës së jashtme për të cilën ka një konsensus në Bosnjë-Hercegovinë”, tha Kristo.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka konfirmuar përkushtimin e tij për reformat që duhet të bëhen për ta zbatuar Planin.

Kryeministri shqiptar Edi Rama theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në rrugën drejt Bashkimit Evropian. “Është koha që rajoni të bëhet pjesë e portofolit digital të Evropës. Individualisht, ne të

gjithë u përfshimë dhe synojmë të jemi gati deri në vitin 2027”. Ai theksoi bashkëpunimin në fushën e migracionit, trafikimit të qenieve njerëzore, “jo vetëm midis rajoneve, por edhe midis rajoneve dhe BE-së”.

Presidenti serb Aleksandar Vučić tha se Plani i Rritjes do të sjellë rezultate të mira në rajon: “Ne vlerësojmë dhe jemi mirënjohës për paratë, por më të rëndësishme se paratë janë reformat strukturore që duhet t'i zbatojmë dhe këtë e vlerësojmë shumë”.

Ai tha se është i bindur se vendet e rajonit nuk do të hyjnë në BE para Ukrainës.

“Inteligjenca ime më thotë se do të jetë kështu. E di që BE-ja është shumë e njohur në vendet tuaja. Jo aq shumë në të mia”.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, konfirmoi se janë të përkushtuar për reformat evropiane, duke vlerësuar se për suksesin e formimit të tregut të përbashkët, është i nevojshëm zhbllokimi i Marrëveshjes për Tregtinë të Lirë të Evropës Qendrore.

## Kuvendi miraton disa marrëveshje ndërkombëtare, përfshirë atë ushtarake me Turqinë

**PRISHTINË, 16 MAJ** - Në dy seanca plenare, Kuvendi i Kosovës ka miratuar shumicën e marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshirë marrëveshjen kornizë ushtarake me Turqinë. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare kishe mbetur pezull që një kohë për shkak të mungesës së votave të majtueshme. Sipas Ligjit në Kosovë, marrëveshjet ndërkombëtare mund të ratifikohen vetëm me votat e dy të tretave të deputetëve.

Sipas Qeverisë së Kosovës, marrëveshja me Turqinë parashih bashkëpunim, ndër të tjera, në operacione paqeruajtëse, humanitare dhe kundër terrorizmit. “Kjo marrëveshje parashih bashkëpunimin në këto fusha: stërvitje dhe edukim ushtarak, industri dhe mbrojtje, shkëmbim të inteligjencës ushtarake, mjekësi ushtarake, operacione paqeruajtëse dhe humanitare kundër terrorizmit e të tjera”, tha ministri i Bujqësisë, Faton Peci, derisa e arsyetoi marrëveshjen në mungesë të ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.

Dy prej marrëveshjeve



ndërkombëtare nuk morën mbështetjen e nevojshme të deputetëve gjatë seancave plenare të 16 majit. Traktati ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektes në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze, si dhe Marrëveshja e kredisë për programin e financave publike dhe rritjes ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Fondit OPEC për

Zhvillim Ndërkombëtar. Me përkrahjen e deputetëve nga partitë opozitare u arrit miratimi, ndër të tjera, edhe i Ligjit për ratifikimin e “amendamentit 3 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2015”.

Ligjvënësit mbështetën edhe marrëveshjen me Bankën Evropiane për projektin e trajtimit

të ujërave të zeza në Ferizaj. Sipas Qeverisë së Kosovës, kjo marrëveshje arin vlerën prej 20 milionë eurove.

Gjithashtu, Kuvendi miratoi Ligjin për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm.

Deputetët miratuan edhe Ligjin për marrëveshjen ndërkombëtare me Bashkimin Evropian në atë që quhet Programi i tregut të vetëm.

Në seancën e 16 majit u miratua edhe Marrëveshja ndërkombëtare me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim.

Subjekti opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, bëri me dije më 15 maj se do t'i votojë marrëveshjet ndërkombëtare, vetëm një ditë pasi kreu i kësaj partie, Memli Krasniqi, zhvilloi një takim me kryeministrin Albin Kurti.

Marrëveshjet ndërkombëtare arrijnë vlerën e 300 milionë eurove, ka thënë më herët ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati.

Në seancën e së enjtes, që është vazhdim i asaj që është mbajtur më 2 maj, në rend ditë ishte edhe votimi i Projektrezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit amerikan të Shtetit. Me kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, votimi u shty për një seancë tjetër meqë, sipas tyre, “rezoluta nuk është e plotë”. “Kërkojmë më tepër kohë për harmonizimin e qëndrimeve për plotësimin e rezolutës”, tha shefia e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila.



# Përplasje në mes të Qeverisë dhe Presidencës për letrën dërguar në KiE pa konsultim me presidenten Osmani

Ministrja për Punë të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka bërë me dije se në kuadër të procesit të anëtarësimit në Këshillin e Evropës, të mërkurën i ka dërguar një letër presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Ajo ka thënë se letra përmban zotimin që Qeveria e Kosovës do të përgatisë një draft për krijimin e një mekanizmi për vetëmenaxhim, koordinim dhe bashkëpunim të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Gërvalla ka shtuar se presin nga Këshilli i Evropës ta përmbushë pjesën e vet të detyrimit dhe ta ftojë Kosovën për t'iu bashkuar pa vonesë Këshillit të Evropës. Por nga Presidenca kanë reaguar duke theksuar se për letrën dërguar në KiE nuk janë konsultuar dhe marrë vesh me presidenten Osmani

## **SPOKA** **ERE** Mal QORRAJ

**PRUSHITINË, 16 MAJ** - Ministrja për Punë të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, tha se nëpërmjet një letrë e ka njoftuar Këshillin e Evropës, se Kosova po përgatit një draft-statut për themelimin "një mekanizmi për vetëmenaxhim, koordinim dhe bashkëpunim të komunave me shumicë serbe në Kosovë". Ky draft do të dërgohet për interpretim në Gjykatën Kushtetuese deri në fund të muajit maj.

Qeveria ka pranuar në herët se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është vënë kusht për pranimin e

shtetit në organizatën e Këshillit të Evropës.

Sipas Gërvallës, ky draft-statut plotëson nevojat e qytetarëve të komunitetit serb, njëkohësisht respekton Kushtetutën e Kosovës dhe parimet e Këshillit të Evropës. "Në kuadër të procesit të anëtarësimit në Këshillin e Evropës, pas votës prej 82 % të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në favor të këtij anëtarësimi, në kuadër të zotimeve të marra nga tre kretrat e shtetit, sot në mëngjes i kam dërguar një letër presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Letra përmban zotimin që Qeveria e Republikës së Kosovës do të përgatisë një draft për krijimin e

një mekanizmi për vetëmenaxhim, koordinim dhe bashkëpunim të komunave me shumicë serbe në Kosovë, i cili përmbush detyrimet e trashëguara ndërkombëtare të Kosovës, plotëson nevojat e qytetarëve të komunitetit serb të Republikës së Kosovës, njëkohësisht respekton në tërësi dhe në secilin detaj të tij Kushtetutën dhe të gjitha ligjet e Republikës së Kosovës, njëkohësisht edhe parimet e Këshillit të Evropës. Një draft i tillë i shërben në njërin anë synimit të qeverisë për t'i integruar komunitetet joshumicë dhe zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës në të gjitha komunat. Drafti siguron jo vetëm respektimin e

plotë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës por, në të njëjtën kohë, pamundëson ndërhyrjet e palejueshme nga jashtë si në komunat e Kosovës, po ashtu edhe në të gjithë vendin", ka thënë Gërvalla.

Ajo ka shtuar se presin nga Këshilli i Evropës ta përmbushë pjesën e vet të detyrimit dhe ta ftojë Kosovën për t'iu bashkuar pa vonesë Këshillit të Evropës, të cilit jo vetëm që i janë vendosur më së shumti kushte për anëtarësim në këtë organizatë, por i cili i ka përmbushur të gjitha këto kushte. "Kosova e pavarur dhe sovraane, si shtet ligjor dhe demokratik, mbetet në kursin e saj të palëkundur drejt anëtarësimit në NATO dhe BE", ka thënë Gërvalla.

Më 16-17 maj Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës takohet në Strasburg. Ky organ jep fjalën për pranimin e një shteti apo jo. Më 14 maj zëvendësiministri për Punë të Jashtme, Kreshnik Ahmeti, tha se çështja e pranimit të Kosovës në këtë organizatë për të drejtat e njeriut nuk është përfshirë në agjendë. Gerald Knaus, nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet, ka publikuar në "X" letrën e plotë që Gërvalla i ka dërguar presidentit të

Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ligjvënës grek Theodoros Rousopoulos. Në letrë, autenticitetin e së cilës Qeveria e Kosovës e konfirmoi për "Radion Evropia e Lirë", thuhet se draft-statuti që po përgatit Kosova do t'i dërgohet për interpretim Gjykatës Kushtetuese të Kosovës deri në fund të majit. "Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës po përgatit draft-statutin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe [në kuadër të obligimeve të neneve 7 dhe 10] të frymëzuar nga organizata 'Friedrich Ebert'. Do të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim deri në fund të majit të vitit 2024", thuhet në letrë.

Nenet, që janë referuar në këtë letrë, kanë të bëjnë me Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raportëve dhe Aneksin për zbatimin e marrëveshjes, që Kosova dhe Serbia arritën vitin e kaluar në dialogun që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Neni 7 i kësaj marrëveshjeje parashihet sigurimin e një niveli "të përshatshëm të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë". Aty, po ashtu, përfshihet edhe zyrtarizimi i statusit për Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë.

Ndërkaq, neni 10 thotë se Kosova dhe Serbia konfirmojnë detyrimet e tyre që t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog.

Këshilltari për media i presidentes, Bekim Kupina, ka bërë me dije se për letërnënë Qeverisë së Kosovës dërguar KIE nuk janë konsultuar dhe marrëveshjet me presidenten Vjosa Osmani.

Presidenca ka theksuar se çdo derivat i letërnësë zotimeve të nënshkruara nga tri institucionet duhet paraprakisht, po ashtu, të koordinohet dhe miratohet nga po këto tri institucione. "Presidentja Osmani përkrah vetëm qëndrime dhe veprime paraprakisht të konsultuara, të koordinuara dhe të dakorduara me institucionin e Presidencës si institucion kushtetues me kompetenca të qarta në fushën e politikës së jashtme dhe si gardian i funksionimit kushtetues të institucioneve. Kjo letër nuk është e tillë. Mund

të jetë konsultuar e koordinuar me individë jashtë institucioneve që sot e kanë publikuar këtë letër, por jo me Presidencën. Çdo derivat i letërnësë zotimeve të nënshkruar nga tri institucionet duhet paraprakisht të koordinohet dhe miratohet nga po këto tri institucione.

Presidentja Osmani gjatë gjithë ditës po vazhdon konsultimet me aleatët rreth çështjes së anëtarësimit në Këshill të Evropës, ashtu siç ka bërë për një kohë të gjatë, me qëllim të zhblokimin të këtij procesi.

Rrjedhimisht, presidentja Osmani do ta mbështesë çdo veprim në drejtim të realizimit të këtij synimi, në përputhje të plotë me interesat shtetërore dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj edhe po bën përpjekje që shtetet anëtare të binden që sa më parë që të jetë e mundur të thirret një seancë e jashtëzakonshme ku do të votohet për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë", ka

thënë këshilltari për media i presidentes, Bekim Kupina.

Nga Qeveria e Kosovës thanë se është në dorën e bashkësisë ndërkombëtare ta pranojë "ofertën" për themelimin e Asociacionit, duke u zotuar se janë të gatshëm ta zbatojnë këtë në kuadër të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve. "Nëse bashkësia ndërkombëtare e pranon tash, një vit pas, një ofertë, të tillë ne jemi të gatshëm ta zbatojmë, në kuadër të zbatimit të plotë të Marrëveshjes Bazike dhe në kontekst të anëtarësimit në Këshillin e Evropës. Por, kjo varet nga bashkësia ndërkombëtare, jo nga qeveria jonë", ka shkruar në "Facebook" zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu. Deri më tani, për themelimin e Asociacionit, janë paraqitur disa draft-statute, përfshirë një të Bashkimit Evropian fundvitin e kaluar, por edhe nga organizata gjermane Friedrich-Ebert-Stiftung (FES).

Zyrtari i lartë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka thënë se Qeveria e Kosovës po e jep edhe Asociacionin edhe tokat e Manastirit të Deçanit, ndërkaq e humbi shansin për anëtarësim në Këshill të Evropës.

Daut Haradinaj në "Facebook" ka shkruar se humbja e momentumit për anëtarësim në Këshillin e Evropës është humbje e madhe. "Humbja e momentumit që Kosova të pranohet në Këshillin e Evropës është humbje e madhe. Për çudi, qeveria tash zotohet se do ta dërgojë brenda një jave draftin e Asociacionit në Gjykatën Kushtetuese. Pra, me një fjalë, edhe Zajednicën edhe tokat iu dhanë Manastirit, ndërkaq e humbëm shansin për anëtarësim në Këshill të Evropës. Çfarë logjike primitive e këtyre amaterëve është kjo?", ka thënë Daut Haradinaj.

Deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, ka reaguar ndaj letërnësë së Gërvallës drejtuar KIE-

së. "Albin e Donikë, propagandën e mashtrimin ruajeni për konsum të brendshëm. Nuk iu ecë me shtetet e KIE-së! E para, dhe më e rëndësishmja adresimi i letërnësë është gabim, sepse AP KIE e ka dhënë qëndrimin! E dyta, të anëtarësohesh në një organizatë duhet të tregosh seriozitet si shtet dhe jo shtet me surpriza pasi përton pamaturit dhe kjo dëmton perceptimin që Kosova me vështirësi e ka ndërtuar, atë të shtetit serioz. Prandaj këto lëvizje e qëndrime të çoroditura janë shembuj jo ndihmës për një imazh të shtetit serioz. Maturia dhe pjekuria është një kriter i rëndësishëm i konsolidimit të shtetit. E treta, mos merrni hapa që t'i thuhet KIE-së se ne u treguam të gatshëm dhe përsëri ju nuk morët vendim? Aleatët tanë janë besnik ndaj Kosovës dhe të ardhmes së saj, për të tjerat diskutohet më vonë", ka shkruar Musliu-Shoshi në "Facebook".



## Aktakuzë ndaj dy serbëve për krime lufte ndaj shqiptarëve

**PRISHTINE, 16 MAJ** - Prokuroria Speciale ka ngritur të mërkurën aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër dy të pandehurve me inicialet D. M dhe Z. K., të nacionalitetit serb.

Prokuroria Speciale njofton opinionin publik se të pandehurit Z. K. dhe D. K. gjatë kohës se luftës në Kosovë, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të policisë, ushtrisë dhe paramilitarë serbë, të veshur me uniformë të policisë dhe të

armatosur, me vetëdije dhe qëllim, duke vepruar sipas planit dhe urdhrave të eprorëve të tyre, kanë marrë pjesë në sulmin kundër popullsisë civile të nacionalitetit shqiptarë. "Me këtë në bashkëkryerje Z. K. dhe D. K. kanë kryer veprën

penale 'Krime lufte kundër popullatës civile' nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, të paraparë edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të

Gjenevës nga neni 146 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPRK-së, ndërlihur me nenin 31 të KPRK-së. Dy të akuzuarit nga shtatori i vitit 2023 gjenden në masën e paraburgimit", ka njoftuar Prokuroria Speciale.

## MKRS-ja dhe British Council, marrëveshje bashkëpunimi në fushën e artit dhe ekonomisë kreative



**PRISHTINË, 16 MAJ** - Ministria e Kulturës dhe British Council kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e artit dhe ekonomisë kreative. Në tri vitet e ardhshme British Council do të bashkëpunojë me MKRS-në për zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme për ta mbështetur zhvillimin e

ekonomisë kreative në vend. Ministria e Kulturës ka njoftuar se marrëveshja do të fokusohet në hartimin e politikave, kërkime dhe avokim në sektorin e ekonomisë kreative dhe ngritjen e kapaciteteve për profesionistët krijues dhe politikëbërësit, duke siguruar që individët dhe organizatat në fushën e industrisë kreative të rriten,

të arrijnë potencialin e tyre dhe të bëjnë një ndryshim të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm. Memorandumi është nënshkruar nga ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku dhe drejtoresha për Kosovë e British Council, Majlinda Mazelliu, në praninë e ambasadorit të Britanisë së Madhe në Kosovë, Jonathan Hargreaves.

## KMDLNj përgëzon deputetët që nuk e votuan traktatin për burgje me Danimarkën

**PRISHTINË, 16 MAJ** - Në Kuvendin e Kosovës nuk ka kaluar marrëveshja me Danimarkën në lidhje me burgjet. "Kosova asgje nuk përfiton me këtë marrëveshje përveç se diskriminon të burgosurit kosovarë dhe të tjerë që janë në institucionet korrektuese dhe të paraburgimit duke krijuar kushte pakrahasimisht më të mira për të transferuarit nga Danimarka që janë me rrezikshmëri të lartë dhe të papërmirësueshëm. Edhe stafi korrektues i Kosovës diskriminohet krahasuar me ata që do t'i shërbejnë administratorit nga Danimarka që do të udhëheq burgun në Gjilan. MD e Kosovës ka mashtruar opinionin në Kosovë sikur edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës duke mos ua treguar të vërtetën për këtë marrëveshje për faktin se brenda një shteti po legalizohen dy sisteme korrektuese, ai danez dhe

ekzistuesi i Kosovës që diametrisht bëjnë dallime në trajtimin e të burgosurve dhe stafit korrektues. Komiteti për Parandalimin e Torturës i Kombeve të Bashkuara i ka identifikuar të njëjtat shkelje të rënda të të drejtave të njeriut sikur edhe KMDLNj andaj ka kërkuar nga Danimarka anulimin e kësaj marrëveshjeje", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se me këtë marrëveshje shkelen të gjitha standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria të mbrojtura dhe të garantuara me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. KMDLNj-i ka përgëzuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që nuk e votuan këtë traktat diskriminues dhe racist që është shkatërrues për Shërbimin Korrektues të



Kosovës, rrezikon sigurinë e vendit duke krijuar njësi ekstraterritoriale ku Kosova nuk do të ketë qasje. "Asnjë marrëveshje e tillë nuk mund ta

gjëni në asnjë vend të botës përveç se në Shqipëri, Ruanda dhe tani në Kosovë që nga shtetet e fuqishme ekonomike dhe politike trajtohen si koloni për

vendosje të refugjatëve dhe të burgosurve problematikë dhe të rrezikshmëri të lartë dhe të papërmirësueshëm", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

## Përrurohen renovimet në Klinikën e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve



**PRISHTINË, 16 MAJ** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka marrë pjesë në përirimin e renovimit të objektit të Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, drejtori i Bankës Botërore në Kosovë, Massimiliano Paolucci, drejtori i Klinikës së Psikiatrisë, dr. Faton Kutlovci, si dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë. Ministri Vitia ka theksuar se nga sot në këtë klinikë shërbimet nuk do të jenë më vetëm

ambulatore, pasi që tani është i mundshëm edhe hospitalizimi për fëmijët dhe adoleshentët, gjithnjë me indikacione dhe me protokolle të standardizuara. "Për herë të parë në klinikën e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve do të kemi shtretër. Në repartin për fëmijë dhe adoleshentë, me ngritjen e kapaciteteve, do të lehtësohet puna e profesionistëve dhe fëmijët e adoleshentët tani e tutje do të marrin shërbime me kujdes më afatgjatë, sepse deri tani në këtë repart janë ofruar vetëm

shërbime ambulatore. Po ashtu, kemi shtuar shërbimin për Logopedi. Në të kaluarën është bërë vetëm diagnostikimi i autizmit, ndërsa tani janë krijuar kushtet edhe për trajtim", tha Vitia. Po ashtu, ministri Vitia shtoi se ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e shëndetit mendor, me theks të veçantë për fëmijët, mbetet i nevojshëm, e për të Ministria e Shëndetësisë për vitin 2024 ka ndarë 50 000.00 euro për t'i mbështetur organizatat joqeveritare të cilat kanë në fokus shëndetin mendor.

## Përfundon rinovimi i shkollës "Skënderbeu" në Hogosht

Kamenicë, 16 maj - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, pikërisht në ditën e shkollës, me nënkolonelin Ryan Conley dhe drejtorin e shkollës Arsim Guda, kanë zbuluar pllakën e cila vë në pah kontributin e jashtëzakonshëm të dhënë nga

Ambasada Amerikane. "Një investim prej 340 000 dollarësh, i cili ka garantuar një ndryshim rrënjësor të ambienteve të kësaj shkollë", ka thënë Rahimaj. Ky investim përfshin rregullimin e hapësirës së brendshme të shkollës, sistemin e ngrohjes,

nyjat sanitare, ndriçimin, dyert dhe dritaret. Rahimaj ka thënë se nxënësit e kësaj shkolle tani do t'i vijnë mësimet në kushte më të mira. "Shkolla në Hogosht ka marrë pamje krejtësisht tjetër", ka shtuar ai.



## Krasniqi takon ambasadorin Hovenier, flasin për zgjedhjet e parakohshme

PRISHTINE, 16 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka takuar të mërkurën ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier, ndërsa kanë biseduar për zhvillimet e fundit politike në vend. Krasniqi në "Facebook" ka shkruar se ambasadorin

Hovenier e ka njoftuar edhe rreth qëndrimeve të PDK-së për zgjedhjet të parakohshme. "Në zyrat e Grupit Parlamentar të PDK-së, sot takova ambasadorin e ShBA-së, Jeffrey Hovenier, me të cilin diskutuam për zhvillimet e fundit politike në vend. Ambasadorin Hovenier

e njoftova me qëndrimet e PDK-së rreth këtyre zhvillimeve dhe me arsyet e kërkesës tonë për zgjedhje të parakohshme. Ne besojmë se vendi është në stagnim të plotë dhe ata që po e pësojnë më së shumti janë qytetarët tanë", ka bërë me dije Krasniqi.



## Escobari largohet nga pozita i tij për Ballkanin, Hovenieri: Kisha nderin të punoj për t'i avancuar qëllimet në dialog

PRISHTINE, 16 MAJ - Emisari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka përfunduar tashmë mandatin në këtë detyrë.

Ambasadori amerikan Jeff Hovenier i ka uruar Escobarit gjitha të mirat në detyrën e tij të ardhshme dhe e ka falënderuar për bashkëpunim. "Ndërsa miku dhe kolegu im Gabriel Escobar përfundon detyrën e tij si Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, i uroj gjithë të mirat në detyrën e tij të ardhshme. Kam pasur nderin të punoj me të për t'i avancuar qëllimet e ShBA-së në Kosovë dhe në dialogun e BE-së. I shpreh

falënderimet e mia për përkushtimin e tij të palodhur në avancimin e vizionit tonë për një Kosovë dhe rajon të Ballkanit Perëndimor të sigurt, të begatë dhe demokratik", ka shkruar Hovenieri.

I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, gjatë një bisede virtuale me gazetarë gjatë javës së kaluar, tha se në fund të këtij muaji përfundon mandati i tij. Ai shtoi se pozita ishte dyvjeçare, por kishte kërkuar edhe një vit shtesë me shpresën se do të bëhej përpamim drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.



## Votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, Hamza falënderon deputetët

PRISHTINE, 16 MAJ - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka falënderuar deputetët e të gjitha partive të cilët votuan marrëveshjet ndërkombëtare. Hamza në "Facebook" ka shkruar se këto marrëveshje përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve. "Qytetarët e Kosovës meritojnë të jetojnë shumë më mirë. Sot, deputetët e të gjitha partive i votuan marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat kanë ndikim konkret në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë. I falënderoj deputetët që votuan

për miratimin e këtyre marrëveshjeve. Personalisht, jam mirënjohës dhe falënderues ndaj të gjithëve. Këto marrëveshje ndërkombëtare mund t'i sjellin Kosovës përfitime me miliona euro vetëm me dinamikën e punës që do ta krijojmë me qeverisjen e re. Kjo ka qenë gjithmonë bindja ime dhe është qëndrimi im i shprehur së fundmi edhe publikisht më 4 prill. Përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve dhe interesi i vendit, ka qenë, është dhe do të mbetet misioni im i përhershëm në politikë", ka shkruar Hamza.



## Bislimi takon zëvendëskryeministrin e Malit të Zi, flasin për thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINE, 16 MAJ - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka mirëpritur në takim zëvendëskryeministrin për politika ekonomike të Malit të Zi, Nik Gjelogaj.

Përgjatë takimit u diskutua mbi marrëdhëniet e veçanta ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi si dhe për mundësitë për të thelluar bashkëpunimin mes nesh. U nënvizua rëndësia e ndërimit të urave të reja të bashkëpunimit dhe u veçuan projektet e

ndryshme infrastrukturore. Procesi i integritit evropian dhe orientimi i qartë e i palëkundur për anëtarësim në Bashkimin Evropian ishte një prej temave të bashkëbisedimit. U trajtua edhe situata aktuale në vend, raportet e mira

ndërfqinjësore dhe çështjet rajonale. Duke e falënderuar për zbatimin, bisedën e pikëpamjet e shkëmbyera, zëvendës-kryeministri Bislimi i dëshiroi sukses e qëndrim të frytshëm në Kosovë zëvendëskryeministrin Gjelogaj.



## Biznese shqiptare nga Turqia, të gatshme të investojnë në Gjilan

**GJILAN, 16 MAJ** - Një grup afatëshës shqiptarë nga Turqia kanë vizituar komunën e Gjilanit. Ata janë pritur nga nënkryetarja Leonora Morina-Bunjaku dhe nënkryetari Kadir Hyseni. Ajo në emër të kryetarit Alban Hyseni i ka falënderuar mysafirët nga Turqia për kontributin e dhënë para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, posaçërisht në komunën e Gjilanit.

Nënkryetarja Morina-Bunjaku u zotua se komuna e Gjilanit do të bashkëpunojë me bizneset

shqiptare nga Turqia të cilat janë të mirëpritura për investime. "Prioritet i kryetarit Hyseni dhe komunës është zhvillimi ekonomik. Kemi politika tërheqëse lokale për thithjen e investimeve. Pas përfundimit të procedurave do të bëhet edhe Zona Ekonomike, ku bizneset do ta kenë të gjithë infrastrukturën adekuate", ka thënë Morina-Bunjaku.

Nënkryetarja e komunës i ftoi bizneset shqiptare e turke që të vijnë të investojnë në Anamoravë. "Jemi të hapur për

bashkëpunim të zhvillimit ekonomik dhe më gjerë", ka pohuar Morina-Bunjaku.


Ndërsa Gokhan Biçen, kryetar i Unionit të Bizneseve Shqiptare në Turqi, falënderoi zyrtarët e komunës së Gjilanit për pritjen. "Jemi të interesuar për investime në fushën e prodhimit në komunën e Gjilanit e më gjerë", ka thënë kryetar Biçen. Ai tregoi se kanë ardhur rreth 20 përfaqësues të bizneseve shqiptare nga Turqia me qëllim të zhvillimit ekonomik të vendit.



## BE-ja: Kosova dhe Serbia, pa gatishmëri për kompromis rreth përdorimit të dinarit

**PRISHTINE, 16 MAJ** - Në Bruksel për të shtatën herë me radhë kryenegociatori i Kosovës dhe ai Serbisë dështuan të arrijnë një marrëveshje lidhur me përdorimin e dinarit serb për pagesa me para në dorë në zonat e banuar me shumicë serbe në Kosovë. Para takimit që patën të mërkurën, i dërguari evropian për bisedimet në mes të palëve, Miroslav Lajçak, tha se u ka paraqitur palëve një dokument kompromisi në një përpjekje për t'i tejkaluar dallimet, por pa dhënë hollësi se për çfarë propozimi bëhet fjalë.

Bashkimi Evropian shprehu keqardhjen për dështimin e bisedimeve, ndërsa vlerësoi se "nuk ka gatishmëri për të gjetur një marrëveshje kompromisi në të ardhmen". Një zëdhënës i bllokut tha se përgjatë takimeve, Bashkimi Evropian paraqiti ide dhe propozime dhe palët arritën të tejkalonin disa nga dallimet e tyre, duke përfshirë pajtimin "për themelimin e një entiteti të ri biznesi sipas ligjeve të Kosovës, që do ta kryente shpërndarjen e përkohshme të ndihmës financiare nga Serbia". Por, pavarësisht se BE-ja paraqiti një propozim kompromisi për t'i përshtatur



qëndrimet e palëve, ato nuk arritën të pajtohen për disa çështje thelbësore, "përfshirë shtrirjen e veprimtarisë së njësies së re, fushëveprimin e përfuttesve të këtij entiteti, dhe ndihmën financiare nga Serbia për institucionet e mbështetura prej saj në Kosovë", tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, në një komunikatë pas takimit. Takimi i fundit, tha zëdhënësi, dëshmoi se palët nuk janë në gjendje të gjejnë një zgjidhje kompromisi dhe nuk ka gatishmëri për të gjetur një

marrëveshje të tillë në të ardhmen. Duke theksuar se mungesa e një pajtimi ka pasojë negative në jetën e përditshme të serbëve të Kosovës dhe është një burim i vazhdueshëm shqetësimesh, zëdhënësi tha se Bashkimi Evropian si lehtësues "mbetet i gatshëm të organizojë një takim tjetër për këtë temë sapo palët të shprehin gatishmërinë për të gjetur një zgjidhje të pranueshme të ndërsjellë".

Kryenegociatori i Kosovës dhe ai Serbisë e akuzuan njëri-tjetrin

për dështimin e bisedimeve. Kryenegociatori serb Petar Petković tha se Prishtina refuzoi gjashtë propozime të Beogradit, ndërsa theksoi se "do të vazhdojmë të kërkojmë zgjidhje dhe dera e bisedimeve nuk është e mbyllur për ne, meqë pa zgjidhje është më e vështirë për serbët në Kosovë".

Ndërsa kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se qasja e Serbisë flet për dy qëllime: "qëllimin e parë e ka t'i legjitimijë strukturat paralele pra, sipas saj, zgjidhja duhet të

kërket në kalimin nga një sistem paralel ilegal në një sistem paralel legal. Domethënë, një sistem ku nuk ka kurrfarë interference ndërmjet qytetarëve të komunitetit serb dhe atyre shqiptarë. Zgjidhja, sipas tyre, është në një sistem i cili e siguron edhe më tej mungesën e plotë të transparencës, rregullimi i së cilës ka qenë një nga qëllimet kryesore të rregullores së Bankës Qendrore", tha Bislimi.

Rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës, e cila hyri në fuqi më 1 shkurt, përcakton se euroja është valuta e vetme që mund të përdoret për pagesa me para në dorë në Kosovë. Rregullorja nxit reagimin e zemëruar të Beogradit, he shqetësimet e diplomacisë perëndimore për ndikimin e saj në jetën e serbëve të Kosovës që vazhdojnë të mbështeten financiarisht nga Beogradi.

Diplomatët i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës ta pezullojë rregulloren dhe t'u jepet kohë qytetarëve të prekur për t'u përshtatur me situatën e re. Çështja e dinarit është shndërruar edhe në temë mospajtimesh mes qeverisë në Prishtinë dhe diplomacisë perëndimore.

## Ministri Murati merr pjesë në Seancën Plenare të Bordit të Guvernetoreve të BERZH-it

**PRISHTINE, 16 MAJ** - Në kuadër të takimeve të 33-ta vjetore të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) që po zhvillohen në Yerevan të Armenisë, të enjten u mbajti Seanca Plenare e Bordit të Guvernetoreve të BERZH-it. Në këtë seancë po merr pjesë edhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, krahas përfaqësuesve të tjerë të shteteve anëtare të këtij institucioni.

Gjatë diskutimit, ministri vuri në dukje performancën e mirë

të ekonomisë së Kosovës, duke nënvizuar përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë për të qenë të vëmendshëm ndaj zhvillimeve globale dhe për t'i mbështetur në mënyrë aktive qytetarët dhe bizneset për tejkalimin e sfidave me të cilat u ballafaquan.

Megjithatë, marrë parasysh ndikimin mbiproporcional që rritja e normave të interesit ka në ekonominë të zhvillim, ministri Murati theksoi rëndësinë e nevojës për rritje të mbështetjes për sektorin privat

nga ana e BERZH-it në mënyrë që të mos ketë mungesë të likuiditetit në treg.

Ministri Murati nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit me institucione si BERZH, që luajnë një rol kyç në promovimin e zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë në rajon. Ai ripërsëriti përkushtimin e Kosovës për të punuar ngushtë me BERZH-in dhe për ta thelluar bashkëpunimin në projekte që do të kontribuojnë në zhvillimin dhe stabilitetin ekonomik të vendit.





# Kështu foli Homo Erectus: Kur filluam të flasim?



Në evolucionin njerëzor lindja e gjuhës konsiderohet një fazë vendimtare. Ndryshe nga komunikimi i thjeshtë, i cili mund të ndodhte me gjeeste ose vokalizime në prani të objekteve të cilave u referohej, gjuha lejonte që "të folurit" të përdorej kur këto objekte mungonin, për të aluduar mbi veprimet e së shkuarës, ose të së ardhmes. Homininët pastaj mund të ndanin mendimin dhe imagjinatën.

## Kur?

Megjithatë, nuk ka asnjë marrëveshje midis studiuesve për kohën e këtij ndryshimi vendimtar. Disa këmbëngulin ta shohin gjuhën si një zotësi të kohëve të fundit, jo më e vjetër se 150 mijë vjet dhe i referohen Homo sapiens-ëve. Të tjerët e shohin si rezultat i një procesi më të ngadaltë që filloi shumë

kohë më parë. Tashmë, një ese nga arkeologu anglez Steven Mithen, *The Language Puzzle*, e vendos fillimin e gjuhës 1.6 milion vjet më parë, pra nga Homo ergaster (ose Homo Erectus).

## Domoshmëria

Në atë kohë ndodhën shumë gjëra që ndikuan në ndryshimin e komunikimit. U shfaqën veglat e gurit, që jo vetëm shprehnin konceptin e simetrisë, por kërkonin komunikim më kompleks për të përcjellë mënyrën se si ishin ndërtuar. Vegla tipike ishte amigdala, një lloj sëpate shumëfunktionale me dy faqe të barabarta dhe në formën e një bajameje të madhe.

Për më tepër, duke qenë pas-trues të thjeshtë, d.m.th pas-trues që merrnin mishin e kafshëve të mëdha tashmë të ngordhura, homininët ishin

bërë grabitqarë të aftë që praktikonin gjuetinë e organizuar. Prandaj, gjuha ishte e domoshme për programimin dhe koordinimin e tyre.

## Truri

Nëse para 2 milionë viteve truri i tyre ishte afërsisht aq i madh sa ai i shimpanzeve, nga 2 në 1.5 milionë vjet më parë pati një encefalizim në rritje me zhvillimin e korteksit frontal, kështu që nga 500 cm kub që ishte ai i australopitëkëve, ishte mbërritur tek 900 cm kub tek Homo. Një tru i madh sa 75% i trurit tonë sot.

## Nga fjalët, tek veprat

Rastësia tjetër e rëndësishme është se rreth 1.6 milionë vjet më parë, homininët e gjinisë Homo u gjendën në Gjeorgji, Kinë dhe Indonezi, dhe për këtë

arsye ishin protagonistë të migrimit nga Afrika: vështrë për t'u zbatuar pa përdorimin e një gjuhe të përbashkët, për grupet që u gjendën në mjediset e reja. Hipoteza e librit të Mithen konvergon me atë të gjuhëtarit amerikan Daniel Everett. Për të shkuar në Indonezi, Homo Erectus me siguri do të kishte nevojë për varka. Për t'i ndërtuar ato dhe për të lundruar, gjuha ishte e nevojshme. Por edhe sipas Everett, gjuha ishte një arrihtë graduale dhe jo një ndriçim i papritur.

## E rëndësishme të kuptohemi


Gjuha e Homo Erectus karakterizohej ende nga gjetet që shoqëronin fjalët: këto, në sasi të kufizuara, në krahasim me gjuhët moderne, mund të ndryshonin kuptimin, në varësi

të tonit të zërit. Vetë Mithen beson se disa aspekte të atij zhvillimi të hershëm gjuhësor 1.6 milion vjet më parë ende mbijetojnë në gjuhët moderne sot.

## Fjalët onomatopelike

Fjalët, të cilat përmes tingujve ose gjatësisë së tyre, përshkruajnë objektet që përfaqësojnë, ishin pothuajse me siguri ndër fjalët e para të folura. Ndonjë shembull? "Boom" dhe "Crack" për të emërtuar rrufe dhe diçka që thyhet, për atë që gërhet, për të thënë se je i mërzhitur, riprodhimi me buzë i zhurmës së valëve të detit apo erës për të treguar këto elemente. Në rastin kur janë përdorur fjalët të strukturuar, pra jo vetëm onomatopelike, është përdorur bashkimi i dy termave: rosa e egër, për shembull, mund të quhet "zog uji". / Focus – Bota.al

**EURO GLASS**  
Adri Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Delegacioni i Dinamo Zagrebit sot vjen në Kosovë

**CPOLLA E RE** Veton ZYMBERI

**PRSHITJE, 16 MAJ** - Një lajm i mirë për sportin e Kosovës, konkretisht për futbollistët e rinj që ëndërrojnë kalimin në futbollin evropian, është se një delegacion i klubit të madh kroat, Dinamo Zagreb, do ta vizitojë Kosovën. Ky delegacion do të mbërrijë sot (e premte) në vendin tonë dhe do të qëndrojë tri ditë, kurse do të mbajë edhe një konferencë për medie të shtunën në Pejë. Përfaqësuesi i agjencisë "Nora Sport 196", Fadil Berisha, njëherësh trajner i futbollit, ka

thënë se delegacioni i klubit kroat në vendin tonë vjen me ftesën e Nenad Gavrilloviç, i cili është edhe themelues i agjencisë "Nora Sport 196". "Kemi një ngjarje mjaft të rëndësishme për futbollin dhe talentët tanë, pasi përfaqësues të klubit të Dinamo Zagrebit vijnë në Kosovë dhe të shtunën në Hotel "Dukagjini" në Pejë nga ora 11:00 do të mbahet konferencë për medie ku do t'i shpalosim detaje të tjera lidhur me këtë vizitë", ka thënë Berisha për "Epokën e re". "Në vendin tonë vjen Vlado Kasalo, që është dora e djathtë e kryetarit të Dinamos, Velimir Zaec dhe dy



bashkëpunëtorë. Kasalo ka qenë lojtar i Osijekut, Dinamo Zagrebit, FC Nurnbergut dhe Mainz 05 si dhe reprezentues i Kroacisë", ka deklaruar Berisha. Berisha më pas ka bërë me dije se tre futbollistë janë afër

nënshkrimit me Dinamo Zagrebin me të cilët punon personalisht. Bëhet fjalë për 19-vjeçarët Vigan Berisha, Dajlon Ramadani dhe Olsi Tabaku. "Kemi mjaft talentë në futbollin tonë, vetëm se duhet të punojmë më shumë dhe të jemi të përkushtuar dhe të vëmendshëm kur kemi të bëjmë me talentët. Gjithmonë kemi pasur talente, por pas pranimit të futbollit në arenën ndërkombëtare, normalisht se është më lehtë që futbollistët nga Kosova të depërtojnë drejt Evropës", ka shtuar Berisha. Klubi kroat Dinamo Zagreb, përveç talenteve, është i

interesuar të bëjë investime edhe në një klub të Superligës, por kjo do të vendoset vetëm pasi të vijë delegacioni në Kosovë. "Dinamo Zagrebi është e interesuar të investojë në një klub të Superligës. Jemi në bisedime me tri klube, me tyre me Llapin. Gjithçka do të vendoset pasi të vijë delegacioni. E mira e gjithë kësaj është se kroatët e dinë potencialin që kemi dhe kanë dëshirë të investojnë dhe më pas t'i transferojnë talentët në vendin e tyre", ka treguar Berisha, i cili që një kohë të gjatë punon me gjeneratat e reja në qytetin e Pejës dhe kontributi i tij në futbollin e Kosovës është i madh.

## Aдеми takohet me presidentin e UEFA-s, Aleksandër Çeferin dhe atë të federatës spanjolle, Pedro Rocha

**PRSHITJE, 16 MAJ** - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka marrë pjesë në takimin e rëndësishëm para Kongresit të FIFA-s me presidentin e UEFA-s, Aleksandër Çeferin në Bangkok. Në takimin e përbashkët të kreerëve të 55 anëtarëve të UEFA-s janë diskutuar sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e futbollit si dhe është diskutuar për mbështetjen e kandidatuarave të shteteve evropiane (Gjermanisë,

Belgjikës dhe Holandës) për organizimin e Kampionatit Botëror 2027 për femra, e ku për kandidatuarën fituese do të vendoset në Kongresin e FIFA-s. Ndërkaq, pas këtij takimi kreu i FFK-së, së bashku me homologun nga Maqedonia e Veriut, Muamed Sejdimi, kanë zhvilluar takim të veçantë me presidentin Çeferin, ku diskutuan disa prej kërkesave të dy federatave në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të futbollit në rajonin tonë.



Presidenti i FFK-së, po ashtu, ka zhvilluar një takim me presidentin e ri të Federatës së Futbollit të Spanjës, Pedro Rocha. Në këtë takim tejet miqësor, presidenti Ademi e uroi homologun e tij për

zgjedhjen në krye të futbollit spanjoll dhe i dëshiroi suksese gjatë mandatit të tij. Ademi dhe Rocha diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit të ngushtë mes dy federatave. "Ndonjëse në aspektin

politik Spanja ende nuk e ka njohur zyrtarisht Kosovën, megjithatë në fushën e futbollit të dyja shtetet janë subjekte të barabarta brenda UEFA-s dhe Spanja në këtë drejtim është treguar korrekte", thuhet në një komunikim të FFK-së. Presidenti Ademi shprehu vullnetin e tij dhe të FFK-së për ta rritur bashkëpunimin me Federatën spanjolle në shumë aspekte, të cilat do të kontribuonin në zhvillimin e futbollit të Kosovës.

## Gjermania publikon listën për 'Euro 2024', Nagelsmanni lë jashtë katër yje

**BERLIN, 16 MAJ** - Trajneri i Kombëtares së Gjermanisë, Julian Nagelsmann, ka lënë katër lojtarë të mëdhenj jashtë skuadrës së tij paraprake për "Euro 2024". Gjermania do ta presë turneun këtë verë dhe është favorita dhe treti për të fituar pas Anglisë dhe Francës. Detyra e Nagelsmannit për të zgjedhur një skuadër për turneun u bë më e lehtë muajin e kaluar kur UEFA votoi për t'i rritur skuadrën nga 23 në 26 lojtarë. Ai tani ka emëruar një skuadër paraprake prej 27 lojtarësh, të cilën një lojtar do ta braktisë përpara afatit përfundimtar për skuadrën më 7 qershor. Mbrojtësi i Borussia



Dortmundit, Mats Hummels (35 vjeç), nuk është përfshirë në skuadër, pavarësisht formës së tij mbresëlënëse për Dortmundin dhe përvojës së madhe pasi ishte pjesë e ekipit fitues të Kupës së Botës në

Brazil në 2014. Gjithashtu nuk ka vend për Timo Werner, i cili ka arritur vetëm dy gola që kur u bashkua me Tottenhamin në huazim nga RB Leipzig në janar. Mësueshori i Bayern Munchenit,

**SKUADRA E GJERMANISË PËR "EURO 2024"**  
Portierët: Oliver Baumann, Manuel Neuer, Alexander Hübner, Marco-Antonio Stegner.  
Mbrojtës: Waldemar Anton, Benjamin Henrichs, Joshua Kimmich, Robin Koch, Maximilian Mittelstadt, David Raum, Antonio Rudiger, Nico Schlotterbeck, Jonathan Tah.  
Mësueshori: Robert Andrich, Chris Führich, Pascal Gross, Ilkay Gundogan, Toni Kroos, Jamal Musiala, Aleksandar Pavlovic, Leroy Sane, Florian Wirtz.  
Sulmues: Maximilian Beier, Nicolas Fullkrug, Kai Havertz, Thomas Müller, Deniz Undav.

Leon Goretzka, gjithashtu është lënë jashtë skuadrës pas formës së vështirë me skuadrën e tij të klubit. Shoku i tij i skuadrës, Serge Gnabry, gjithashtu është lënë jashtë nga Nagelsmanni, por ky fundit shkaku i lëndimit. Gjermania përballlet me Ukrainën dhe Greqinë në

miqësoret muajin e ardhshëm përpara turneut. Ata më pas do të përballen me Skocinë në ndeshjen hapëse të Euros më 14 qershor, me skuadrën e Nagelsmannit që do të përballlet me Hungarinë (19 qershor) dhe Zvicrën (23 qershor) në ndeshjet e tyre të fundit në grup.

## Duka: Vokri më propozoi të kandidoja për Komitet Ekzekutiv të UEFA-s

**TRANE, 16 MAJ** - Presidenti i FSHF-së, Armand Duka, në një intervistë dhënë emisionit "Opinion" në TV Klan, ka thënë se raportet e tij me ish-presidentin e FFK-së, Fadil Vokri, ishin të shkëlqyeshme. Madje e ka treguar një rast kur

legjenda e futbollit shqiptar, sipas tij, i kishte propozuar të kandidonte për Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s. "Po të kthehem në vitet e para, 2002, kur unë jam zgjedhur president i Federatës së Futbollit, unë as që e mendoja se do të kandidoja ose

do të pretendoja për të qenë anëtar i Komitetit Ekzekutiv apo zv/president i UEFA-s. Më vonë, vit pas vitit, fillova të mendoja se ne edhe mund të përfaqësohemi pak më mirë. Pas një mbledhjeje që kishim në Zvicër isha me Fadil Vokrin dhe ai më tha që 'pse nuk

kandidon për Komitet Ekzekutiv' dhe ato fillova dhe e menduar këtë gjë. Takova 2-3 kolegë dhe i pyeta. Pastaj kandidova për Komitet Ekzekutiv. Në zgjedhjet e fundit isha dhe kjo është në përgjithësi tradita në UEFA! ai që votohet më shumë, bëhet



zv/president i UEFA-s. Unë isha më i votuari në Kongres dhe u zgjodha", ka deklaruar Duka.

## Bostoni, finalist i parë në Lindje, Dallasi triumfon në fushën e Oklahomës

Boston, 16 maj - Boston Celtics është ekipi i parë finalist i "play-off"-it në Konferencën e Lindjes. Skuadra e Bostonit fitoi me rezultat 113-98 ndaj Clevelandit, duke fituar 4-1 serinë e takimeve, duke u rikthyer në finalen e Lindjes. Në

fushën e tij ekipi i Bostonit nuk zhgënjoi, duke dominuar në fushë dhe merituar fitoren. Gjashtë lojtarë realizuan mbi 10 pikë. U dalluan Tatum me 25 pikë e 10 rebounde si dhe Horford me 22 pikë e 15 rebounde. Në Konferencën e

Perëndimit, ekipi i Dallast fitoi me rezultat 104-91 në fushën e Oklahomas, duke udhëhequr 3-2 serinë dhe ka shansin e artë të kualifikohet në finale. Një ndeshje e madhe për tekantët, që po kalojnë një moment të mirë. Luka Donçiqi konfirmoi

se është lider në fushë për Dallasin me një "triple double", autor i 31 pikëve, 10 rebounde e 11 asistimeve. Mirë u paraqit edhe Jones Jr. me 19 pikë, ndërsa 30 pikët e Alexander Shai për venditë nuk mjaftuan për të fituar.



## Rahoveci e bën hapin e parë drejt finales

Rahovec, 16 maj - KH Rahoveci e ka bërë hapin e parë drejt finales së plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll. Në "Mizahir Isma", Rahoveci e mposhi Trepçën me rezultat 37:28. Ishte kjo gjysmëfinalja e parë e plejofit. Ndeshja e dytë zhvillohet në fundjavë në Mitrovicë. Me dy fitore sigurohet kalimi në finale. Rahoveci e nisi ndeshjen mirë, ndërsa në pjesën e parë ishte vazhdimisht në epërsi prej 4-5 golash. Mitrovicasit nisën të reagojnë vetëm në minutat e fundit, kur u afruan në dy gola 19:17. Me të nisur pjesa e dytë rezultati u barazoi në 19:19. Më pas Rahoveci kaloi para me një e dy gola, por në pjesën e dytë u zhvillua lojë shumë e fortë. Vetëm në minutat e fundit Rahoveci bëri shkëputje në rezultat. Mali Luzha i realizoi 6 gola për "vreshtarët", ndërsa nga 5 i kishin Jon Muqolli e Florian Rexha. Te Trepça, Akram El Kassassi u shqua me 8 gola. Nga 5 i realizuan Sali Maxhera e Wael Mtibaa. Me nga 11 pritje u dalluan



portierët Arti Luzha i Rahoveci e Marwane Soussi i Trepçës.

### KHF Istogu, finalist i parë

Istogu është finalist i parë i plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll (femrat). Istogu, që është kampion aktual, në gjysmëfinale e eliminoi Samadrexhën. Fitoren e dytë e shënoi të mërkurën mbrëma në Samadrexhë me

rezultat 33:31. Ndeshja ishte shumë e fortë dhe interesante nga fillimi e deri në fund. Në minutën e 57 rezultati ishte i barabartë 29:29. Më pas Istogu u shkëput dy gola, 31:29. Samadrexha u afrua në një gol, por pa barazuar rezultatin. Esmat Muratović i shënoi 9 gola për Istogun, derisa Ana Carolina Gomes i realizoi 8. Sevdanur Ozkan e Fatima Haimeri i kishin nga 7 gola për Samadrexhën.

## Te Ferrari optimistë: Kjo është pista dhe gara e duhur për të fituar para tifozëve tanë

**IMOLA, 16 MAJ** - Botërori i Formulës 1 do të vijojë këtë fundjavë në pistën e Imolas, në garën e parë evropiane të këtij sezoni. Pas gati tre muajsh vërdallë në botë, sporti më i bukur i garave të automobilizimit do të debutojë këtë sezon në "shtëpinë" e Ferrarit, ku italianët shpresojnë të fitojnë. "Pas shumë garash larg shtëpisë, e në nisim sezonin evropian me këtë fundjavë dhe e bëjmë në pistën e Imolas. Jemi në pistën më të afërt me selinë tonë në Maranello, e cila mban edhe emrin e themeluesit tonë", u shpreh Frederic Vasseur për mediet. "Ne i kthehemi formatit klasik, me tri seanca përgatitje dhe kjo është arsyeja pse vendosëm ta sjellim paketën e parë të



përditësimit të SF-24 këtu. Kemi një fundjavë shumë intensive përpara, pasi duhet t'i vlerësojmë me kujdes të gjitha tiparet e reja", u shpreh drejtuesi francez i "kokëkuqes". Më tej ai shtoi se vëmendja më e madhe është e përqendruar te

kualifikueset dhe garat. "Si gjithmonë presim vlera shumë të ngushta me rivalët tanë dhe kur skenari është kaq i ngushtë, konfigurimi i saktë i makinës është vendimtar", ka shtuar Vasseur. "Pas anulimit vjet të garës së Imolas, jemi të lumtur që mund të konkurrojmë sërish në këtë pistë, para tifozëve tanë. Jam i sigurt se do ta mbushin pistën e garës dhe do ta mbinshin tjetër e tyre", ka thënë shefi i Ferrarit. "Kemi besim se mund të jemi protagonistë në këtë pistë, se do të jemi atje dhe do të luftojmë në çdo front. Ne shpresojmë t'u japim atyre ndonjë arsye për t'u gëzuar, pasi mendojmë se kjo është pista e gara e duhur për ta bërë këtë gjë", ka thënë Vasseur.

### SHKURT

#### Duka: I kemi ofruar Sylvinhos rinovim të kontratës

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armando Duka, për "TV Klan" ka thënë se i është ofruar rinovimi i kontratës edhe për dy vjet të tjera trajnerit të kombëtares, Sylvinho. "Ne jemi të kënaqur me atë çfarë ka bërë trajneri Sylvinho dhe i kemi ofruar rinovimin e kontratës për dy vjet të tjera. Synimi kryesor është kualifikimi në Botëror", ka thënë Duka.

#### Allegrini: Juventusi e ka në ADN fitoren

Juventusi e fitoi Kupën e Italisë, pasi triumfoi 1-0 në finalen kundër Atalantës. Trajneri Max Allegrini, i cili u ndëshkua me karton të kuq, vlerësoi ndeshjen e lojtarëve. "Jam i lumtur për djemtë. Ata u dhuruan gëzim të madh klubit dhe tifozëve. Kurrë nuk është e lehtë të fitosh, por bën pjesë në ADN-në e Juve. Thiago Motta si pasues në sezonin e ardhshëm? Klubi do t'i bëjë vlerësimet e veta. Jam shumë i lumtur që jam pjesë e këtij klubi në lavdishëm", u shpreh trajneri rekordmen i këtij kompeticioni. 56-vjeçari e fitoi për herë të pestë Kupën e Italisë, shifër që nuk e ka arritur asnjë prej kolegëve të tij.

#### Gasperini: Jemi të zhgënjyer, tani të fokusohemi në finalen ndaj Leverkusenit

Trajneri i Atalantës, Gian Piero Gasperini, pas humbjes në finale të Kupës së Italisë, është shprehur i zhgënjyer. Ai ka kërkuar që tash të përqendrohen në finalen e Ligës së Evropës ndaj Bayer Leverkusenit. "U përballëm me një kundërshtar të fortë që shënoi menjëherë. Ata u mbrojtën shumë mirë pas golit. E kontrolluam ndeshjen, por nuk arritëm t'i konkretizim rastet e krijuara. Nuk mendoj se skuadra zhvilloi një finale të shëmtuar. Thjesht, Juventusi bëri diçka më shumë se ne. Dha më shumë. Ishte një duel i ashpër dhe i ekuilibruar. Jemi të mërzitur, por jo të zhgënjyer. Le të fokusohemi te finalja me Leverkusenin", u shpreh trajneri i Atalantës.

#### Skriinari nuk bën pjesë në planet e Enriques, PSG-ja e nxjerr në shitje

Milan Skriinari u transferua te Paris Saint Germaini me parametra zero, megjithatë aventura franceze nuk ka shkuar aspak mirë për mbrojtësin slovak. Pas një nisjeje si titullar, Skriinari shfaqti disa probleme fizike dhe së fundi, ndonëse plotësisht i rikuperuar, po ngroh stolin, pasi nuk pëlqehet më nga trajneri Luis Enrique. Sipas "L'Equipe", spanjollu nuk e sheh Skriinari si të përshtatshëm për idetë e tij në futboll dhe ndërtimin e lojës nga mbrapa, ndaj ka dhënë miratimin për shitjen e slovakut gjatë merkatos së verës. Tashmë mbetet të shihet cila do të jetë zgjidhja e mbrojtësit 28-vjeçar, që mund ta pranojë largimin në një tjetër kampionat, ose të zgjedhë të qëndrojë në Paris për ta përfutur pagën e lartë dhe të shpresojë t'ia ndryshojë mendjen Luis Enriques.

## Sane dëshiron ta rinovojë kontratën me Bayernin

Leroy Sane është shprehur i hapur për të qëndruar me Bayern Munchenin edhe përtej kontratës e cila skadon në verën e vitit 2025. Lajmin e konfirmoi "Sky Sports" në Gjermani. Sipas medieve, Sane

është takuar me drejtorin sportiv të Bayernit, Max Eber dhe i ka shprehur dëshirën e tij për të vazhduar, me objektivin e qartë për ta rikthyer ekipin në majën e Bundesligës. Ende nuk ka asnjë

informacion specifik në lidhje me bisedimet nëse klubi i ka ofruar një zgjatje të saj dhe rrogë më të mirë. 28-vjeçari luan që prej vitit 2020 me "bavarezët", kur u largua nga

Manchester City. Në 175 ndeshje me Bayernin, Sane ka realizuar 48 gola. Një lojtar i rëndësishëm për skuadrën gjermane, por që shpesh ka përfunduar në shënjestër se nuk ka qenë

vendimtar në sfidat delikate. Pas përfundimit të sezonit palët do të ulen sërish në bisedime për të vendosur, pasi Bayerni nuk dëshiron që ai të ikë me parametrimin zero pas një viti.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Trepça Shqiptri Akcionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qera të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 16.05.2024 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme në Zyra.

### Shpallje Publike T-24-6

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial  
MITROVICË  
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani  
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com  
Telefoni: +381 28 538 050  
Faks: +381 28 539 202

#### Shpallja Publike

##### Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e hapësirave të objekteve në Njësinë Biznisore Industria Kimike.
- Dhënie me qera e hapësirave të objekteve në Njësinë Biznisore Fabrika e Akumulatorëve
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

##### 1. Njësia Biznisore Industria Kimike Loti 1

Nr	Emertimi i parcelës	Sipërfaqja e pa mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali qerasë (€)
1	Parcela me numër 5 A Pranë Magjistrales	955.00	0.50	0.09	0.59	569.35

##### 2. Njësia Biznisore Fabrika e Akumulatorëve Loti 2

Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar(m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Sipërfaqja e pa mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Ndërtesa Afariste e Fabrikës së Akumulatorëve	3,000.00	6.78	1.22	8.00	24,001.20	1,000.00	0.55	0.10	0.65	649.00	24,650.20

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë 17.05.2024

Data e shpalljes: deri me 05.06.2024

Sqarimi: Data(t) për kërkesës deri: 05.06.2024

Kërkesa për pjesëmarrje: Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 05.06.2024 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepçës Sh.A.  
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

##### Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

##### Shënime shtesë:

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe të gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për m<sup>2</sup> duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks 1.

**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepçës Sh.A.

**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneks 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

#### Aneksi 1 OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Logaritja e vlerës së qerasë	
a	Sipërfaqja e mbuluar m <sup>2</sup>
b	Çmimi për metër katrorë (€)
c = b*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)
D=a*c	Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€)
e	Sipërfaqja e pa mbuluar m <sup>2</sup>
f	Çmimi për metër katrorë (€)
g = f*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)
H=e*g	Vlera e qerasë për sipërfaqen e pa mbuluar (€)
I=D+H	Gjithsejt qeraja (€)

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bijnë në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

#### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përbajtëse të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

#### Aneksi 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 14.05.2024 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

#### Aneksi 4. Përkshkrimi i Aseteve

Përkshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përkshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objektive dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

#### DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m<sup>2</sup> dhe llogaritja përfundimtare në faturim

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "MAXX ISHB KONSTRUKCION" Sh.P.K. me pronar Bajram Zhegrova dhe Lummi Zhegrova, nga Vushtrria ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811955915 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MAXX ISHB KONSTRUKCION" D.O.O. sa vlasnikom Bajram Zhegrova i Lummi Zhegrova od Vuçitrna, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811955915 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "MAXX ISHB KONSTRUKCION" L.L.C. owner Bajram Zhegrova dhe Lummi Zhegrova with headquarters Vuçiterna, has come to the decision to quit its business: 811955915 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Whitegost Gaming Zone" Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811988669 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Whitegost Gaming Zone" D.O.O. od Vushtrria, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811988669 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Whitegost Gaming Zone" L.L.C. with headquarters Vushtrria, has come to the decision to quit its business: 811988669 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Dodaj Group" Sh.P.K. me seli në Klinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810136194 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Dodaj Group" D.O.O. od Klina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810136194 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Dodaj Group" L.L.C. with headquarters Klina, has come to the decision to quit its business: 810136194 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Leunor Çoçaj, shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë, dëftesat, diplomën si dhe certifikatën e Arsimit Profesional.
- Prend Prenrrecaj nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimmazit "Hajdar Dushi" Gjakovë dega në Bishtazhin.
- Dion Millanga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Teknike "N. Nixha" Informatik në Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë më qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

